



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0476

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj - Mexhuani dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE “Via Egnatia SH.P.K.”, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit 615-23-4993-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës, më 08/09/2023, morri këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Via Egnatia SH.P.K.” me nr. 2023/0476, e datës 10/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve”, me numër të prokurimit 615-23-4993-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës.
2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve”, me numër të prokurimit 615-23-4993-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me datë 22.05.2023, Komuna e Podujevës nga cilësia e saj si AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” me nr. të

prokurimit: "615-23-4993-2-1-1".

Me datën 27.06.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE "Via Egnatia SH.P.K." të cilën me vendim me datën 30. 06. 2023 AK e ka refuzuar.

Me datë 10.07.2023 OE "Via Egnatia SH.P.K." ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0476 (numër protokolli).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 21. 07. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të korrigjohet dosja e tenderit në përputhje me nenin 51 të LPP-se dhe nenin 54 të RRPP 001/2022

Sqarimet e ekspertit shqyrtues

Sqarim: OE ankues në pretendimin 1 ka pretenduar se AK-ja ka bërë shkelje të nenëve 7, 27, 51 dhe 69 të LPP-se por nuk i ka elaboruar pretendimet e tij dhe shkeljet e supozuara prandaj shqyrtimi i pretendimeve do të bëhet nga pretendimi 2.

Përgjigje në Pretendimin Nr.1 dhe 2: Lidhur me pretendimet e OE ankues për vendosjen e kriterëve kufizues dhe mos vendosjen e disa kërkesave të domosdoshme për natyrën e projektit si dhe pretendimet se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP 001/2022 eksperti shqyrtues ka marrë për bazë të shqyrtimit RRPP 001/2023, LPP-në si dhe të gjitha dokumentet e ngarkuara në e-prokurim dhe praktikën e mëparshme të AK-ve në Republikën e Kosovës për aktivitetet të ngjashme të Prokurimit.

1. Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me shkeljet e LPP-se Nenit 27A Ndarja e kontratave në Lote eksperti shqyrtues sqaron se sipas Nenit 9 të LPP-se Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur – ZKA i AK-se duhet të bëjë një vlerësim formal të nevojave që duhet përmbushur,

Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parashihet t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të

planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë;

Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues.

Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një “Deklaratë të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve”.

AK-ja sipas kërkesave të LPP-se ka ngarkuar në e-prokurim edhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve dhe e njëjta është aprovuar në përputhje me kërkesat e LPP-se.

Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas LPP-se dhe RRPP 13.2 Në rast të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene ose heterogjene, kontrata mund të ndahet në lote (pjesë) “Pra është në diskrecion të AK-se i cili mund të bëjë përcaktimin e nevojave në përputhje me nenin 9 dhe si rrjedhojë pretendimi i OE ankues se është dashur të ndahen në LOT-e është i paqëndrueshëm.

2. Lidhur me pjesën e pretendimit ku OE ankues e konteston kërkesën a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga vet ai dhe kompania.

Përmbajtja e dosjes së tenderit Aneksi 1 Konceptet themelore të kontratave të mirëmbajtjes

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor përfshin detyrat e mirëmbajtjes rutinë dhe periodike. Mirëmbajtja rutinë konsiston në detyra që janë të nevojshme për të mirëmbajtur funksionimin e rrugës (siç janë, fshirja, larja, prerja e shkurreve, etj.).

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues se është dashur të kërkohej Inxh. i ndërtimtarisë është sqaruar edhe më lartë sipas nenit 9 të LPP-së dhe nga specifikimi teknik dhe përshkrimi i teknik në aneksin 1 të dosjes së tenderit është e qartë subjekti i tenderit dhe sipas vlerësimit të ekspertit AK-ja nuk ka vendosur kritere diskriminuese për këtë pike sepse kërkesa Inxh. i Komunikacionit është kërkesë që mund ta plotësojë pjesa dërmuese e OE, në treg të punës ka mjaftueshëm të diplomuar në drejtimin e kërkuar dhe sipas specifikimit teknik Aneksi 1 është kërkuar Plani i Menaxhimit të Trafikut që përfshin kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me trafikun. Poashtu kërkesa për dëshmi të menaxhimit të së paku një projekti është kërkesë minimale që është në përputhje me nenin 9 të LPP-se, Dosjen e tenderit, Specifikimin teknik Aneksi 1 (faqe 25, 26 të DT).

Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues gjatë kërkesës për sqarim të AK-ja me datën 13.06.2023 në këtë pikë ka deklaruar “Pse nuk është i mundur edhe inxhinier i ndërtimtarisë” që është pajtuar me kërkesën dhe është në kundërshtim me atë çka është pretenduar në ankesën e dorëzuar në OSHP.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi për këtë pjesë nuk është i qëndrueshëm.

3. Lidhur me pjesën e pretendimit që ka të bëjë me kërkesën “Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion.

Të ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania”.

Përmbajtja e dosjes se tenderit Aneksi 1 Konceptet themelore të kontratave të mirëmbajtjes

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor përfshin detyrat e mirëmbajtjes rutinë dhe periodike. Mirëmbajtja rutinë konsiston në detyra që janë të nevojshme për të mirëmbajtur funksionimin e rrugës (siç janë, fshirja, larja, prerja e shkurreve, etj.).

Specifikimet teknike të bashkangjitura në DT janë për mirëmbajtje dimërore dhe në asnjë rast nuk përshkruajnë kërkesa specifike për mirëmbajtje verore.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka mundur ta arsyetojë në mënyrë objektive kërkesën për Inxhinier të Bujqësisë drejtimi (Mbrotja e Bimëve) derisa në specifikim teknik nuk ka asnjë përshkrim për këtë kërkesë përveç një fjalie në paramasë dhe parallogari.

Prandaj bazuar në specifikimin teknik të DT specifikimin teknik, përshkrimin e shërbimeve, paramasë dhe parallogarinë Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa 9.1 & 9.2 - b) nuk është në përputhje me RRPP Neni 17. Paragrafi 17 si dhe neni 25 paragrafi 6, rrjedhimisht vlerëson se pretendimi për këtë pjesë është i qëndrueshëm.

4. Sa i përket pjesës së pretendimit të OE ankues që ka të bëjë me listën e çmimeve eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në sistemin e e-prokurimit ka ngarkuar paramasën e cila ka dy faqe (sheet) të cilat janë të dedikuara për ofertën financiare derisa pjesa tjetër është emërtime të rrugëve. Lista e çmimeve është pjesë e dosjes se tenderit dhe rrjedhimisht edhe pjesë e kontratës sipas nenit 4 të draft kontratës pjesë e dosjes së tenderit. OE-të duhet të jenë të vëmendshëm kur e plotësojnë listën e çmimeve. Pretendimi i OE se është e pamundur që të tenderohet me dy lista nuk qëndron sepse sistemi i e-prokurimit lejon të ngarkohet paramasa me disa faqe ashtu si është e ngarkuar edhe nga AK-ja por që OE-te pjesë e aktivitetit të prokurimit kanë mundësinë edhe të plotësimit të ofertës dhe të skenimit në (pdf) të cilën shumica e OE edhe e bëjnë.

Për me tepër OE që ofertojnë duhet ta plotësojnë edhe formularin e dorëzimit të tenderit e cila përfshin çmimin e përgjithshëm dhe lexohet gjatë hapjes.

AK-ja në paramasën e qytetit dhe të fshatrave ka përshkruar tri tabela të emërtuara si (A, B,C) të cilat janë përmbledhur në total. Fakti se në paramasë kanë qasje të gjithë OE-të njëjtë e vërteton se nuk ka të bëjë me diskriminim. AK-ja në mënyrë që ta lehtësojë ofertimin për OE të interesuar të marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit mund ta vendosin edhe një faqe (Excel sheet) si rikapitullim të dy cmimeve (qytetit dhe fshatrave).

Prandaj bazuar në sqarimet e dhëna eksperti shqyrtues në këtë pikë konsideron se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

5. Lidhur me pretendimet e OE ankues në lidhje me Aneksin 7. tabelën e pajisjeve që duhet të posedojnë OE pika 1

Kamion cisterna special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve të jetë me vëllim mbi 7000 Litra. (Kamion cisterna duhet të ketë mekanizmin për larje nga ana e përparme dhe nga ana e prapme me punëtorë, dhe kërkesën nr. 4 të Aneksit 7 “Kamion (cisternë) special me mekanizëm komplet (thithje, deblokim) për pastrim dhe deblokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit

atmosferik të jetë me vëllim mbi 10000 litra”.

Eksperti shqyrtues vlerëson se përshkrimi i punëve ne dosje të tenderit nuk e përcakton ndonjë kufizim kohor apo ndonjë kërkesë specifike brenda të cilit duhet të behet pastrimi që do të arsyetonte një kërkesë me specifika të tilla. Poashtu kërkesa që kamioni të ketë mekanizëm për larje nga ana e përparme dhe nga ana e pasme me punëtorë nuk ndikon në cilësinë apo shpejtësinë e kryerjes së shërbimit. Për me tepër shërbimi faturohet në bazë të metrave katror të sipërfaqes, prandaj kufizimi i mekanizmit dhe vëllimit të rezervarit në pikën 1 dhe 4 si dhe nuk është në përputhje me Nenin 51 të LPP-se paragrafi 4 (ii) Nenin 69 paragrafin 1 të LPP-se si dhe nenin 8.4 të UOPP.

8.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptojë në lidhje me: i. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe ii. përdorim të drejtë të fondeve publike.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi në këtë pikë është i qëndrueshëm.

1. Pretendimi në lidhje me kërkesën nr. 5, Auto fshese speciale deri në 5 ton për fshirjen e rrugëve dhe trotuareve të qytetit. 6, Auto fshese speciale deri në 3 ton për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit. 9. Auto shportë për krasitje të drunjëve. 12. Traktor me kosë për kositje të hapësirave gjelbëruese deri në 1.5 tonë. 15. Makinë për bluarjen e degëve pas krasitjes.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në këtë pikë ka kërkuar pajisje “deri në” që nënkuptohet se OE-të mund të ofrojnë pajisje me peshë më të vogël, pra ju është ofruar mundësia më e gjerë e ofrimit të llojeve të pajisjes.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesat si më larte janë në përputhje me RRPP dhe pretendimi i OE nuk është i qëndrueshëm.

Ndërsa sa i përket kërkesës 11. Traktor special 4x4 për pastrim bore deri në 2 tonë eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka vendosur kërkesa në përputhje me RRPP nenin 8.4 pika e) sepse e ka kufizuar konkurrencën.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se kufizimi i pajisjes si më larte nuk është në përputhje me RRPP dhe pretendimi i OE është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin Nr. 3:

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimit të OE ankues në këtë pikë i është dhënë përgjigje në pretendimin 1 dhe 2.

Përgjigje në Pretendimin Nr. 4:

Lidhur me pretendimin ankues të OE ankues në këtë pikë eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë hartimit të dosjes së tenderit kërkesat teknike profesionale nuk e ka respektuar në tërësi nenin 51 dhe 69 të LPP-së si dhe nenin 8 të RRPP 001/2022.

Eksperti shqyrtues gjate analizimit te dosjes se tenderit poashtu ka vërejtur se te “Plani i Menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë” AK-ja i referohet “Ligjeve te Shqipërisë”.

Poashtu ne specifikimi teknik te Raportimi AK-ja i referohet “Bazat e mirëmbajtjes do të jenë në kontakt të përhershëm me stacionet meteorologjike të Shqipërisë”

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë pikë i është dhënë përgjigje edhe në pretendimin 1 dhe 2 dhe është i bazuar.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron:

Gjatë përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes, PSH merr në konsideratë qëllimin AK-ve që kontrata specifike kërkojnë kompani profesionale si shkak i natyrës së tyre si dhe për faktin e punëve specifike konform vlerës së parashikuar, por PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

Andaj, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kriterë diskriminuesë, PSH mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është se disa kërkesa të cekura në pretendimet ankimor të OE ankues, si të tilla mund të paraqesin diskriminim, andaj PSH përmes këtij vendimi obligon AK që të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertit shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës së tij. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues, në të gjitha pretendimet ankimore, **përveç pikave të mëposhtme**, lidhur me të cilat PSH konstaton si në vijim:

Lidhur me kërkesën “Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të ketë së paku 1 referencë të udhëhequr të natyrës së njëjtë), PSH ka evidentuar se AK ka dhënë arsyetimet e mjaftueshme për nevojën e këtij inxhinieri duke u bazuar në përvojat paraprake dhe nevojat e tyre në projektin aktual, andaj PSH mbështet arsyetimin e AK-së lidhur me domosdoshmërinë e këtij inxhinieri, deri tek kjo vendim-marrje u bazua poashtu edhe në faktin se inxhinierët mund të angazhohen edhe me parakontrata dhe nuk është kërkesë decitive që OE-të të kenë ata në stafin e rregullt, andaj duke qenë se edhe kërkesa mbi menaxherin si dhe kërkesa mbi inxhinierin lejohen që të angazhohen me parakontratë, PSH poashtu ka marrë në konsideratë deklaratimet e ekspertit se këto profesione ka numër të konsiderueshëm të inxhinierëve në vendin tonë, përfundimisht është arritur në konstatimin se nuk përbëjnë kërkesa diskriminuese apo kufizuese.

Lidhur me pretendimet e OE ankues ne lidhje me Aneksin 7. tabelën e pajisjeve qe duhet te posedojnë OE pika 1 “ Kamion cisterna special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve të jetë me vëllim mbi 7000 Litra. (Kamion cisterna duhet të ketë mekanizmin për larje nga ana e përparme dhe nga ana e prapme me punëtorë, dhe kërkesën nr. 4 te Aneksit 7 “Kamion (cisternë) special me mekanizim komplet (thithje, deblllokim) për pastrim dhe de bllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik të jetë me vëllim mbi 10000 litra”. Sa i përket kësaj kërkesë, PSH ka arritur në përfundimin se ndonëse në shikim të parë pajisja duket të jetë specifike që mund të orientojë drejt ngushtimit të konkurrencës, PSH konstaton se nuk pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit lidhur me këtë pikë për faktin se i njëjti në këtë rast nuk ka argumentuar se pse kjo kërkesë është diskriminuese, andaj në këtë rast obligohet AK që të vërtetojë edhe njëherë duke rishikuar lidhur me pajisjen e kërkuar, se a ka pajisje të tilla në treg në numër të mjaftueshëm në posedim të operatorëve ekonomik si dhe të arsyetojë në mënyrë argumentuese kërkesën e tillë, në koordinim me njësinë kërkuuese, andaj mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së që të sigurojë mos-diskriminimin si dhe kufizimin e konkurrencës.

Lidhur me pretendimet e OE ankues ne lidhje me kërkesën 11. Traktor special 4x4 për pastrim bore deri ne 2 tonë, PSH ka arritur në përfundimin se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit lidhur me këtë pikë për faktin se i njëjti në këtë rast nuk ka argumentuar se pse kjo kërkesë përbën diskriminim, ndërsa AK lidhur me të njëjtën në raportin e ekspertit është përgjigjur “ *sepse AK ka kërkuar makineri e cila është e nevojshme për realizimin e kontratës dhe përderisa ka prodhues dhe makineri të njëjtë në tregë nuk ka kurrfar kufizimi të kapacitetit, sepse sheshi i qytetit eshte me pllaka shum te rreshqitshme dhe nuk mund të intervenohet me makineri tjera po ashtu edhe trotuaret janë të ngushta dhe përprjetëza, andaj nuk ka kurrfar arsye të jepet një mendim i tillë*” andaj PSH në këtë rast ka marrë në konsideratë se duke pasur parasysh se në këtë kërkesë është lejuar edhe tonazhe “deri në 2 ton” që nënkupton se nuk është kërkuar kapacitet fiks por është lejuar edhe pajisje me tonazhe më të vogël, e poashtu pajisjet mundësohen që të sigurohen përmes qeramarrjes dhe jo pronësisë së obligueshme, andaj ky pretendim klasifikohet si i pa-bazuar.

Sa i përket pjesës së pretendimit te OE ankues që ka të bëjë me listën e çmimeve, PSH ka konsideruar të gjeturat e ekspertit shqyrtues që ka sqaruar se *AK-ja në sistemin e eprokurimit ka ngarkuar paramasën e cila ka dy faqe (sheet) të cilat janë të dedikuara për ofertën financiare derisa pjesa tjetër është emërtime të rrugëve. Lista e çmimeve është pjesë e dosjes se tenderit dhe rrjedhimisht edhe pjesë e kontratës sipas nenit 4 të draft kontratës pjesë e dosjes së tenderit. OE-të duhet të jenë të vëmendshëm kur e plotësojnë listën e çmimeve. Pretendimi i OE se është e pamundur që të tenderohet me dy lista nuk qëndron sepse sistemi i eprokurimit lejon të ngarkohet paramasa me disa faqe ashtu si është e ngarkuar edhe nga AK-ja por që OE-te pjesë e aktivitetit të prokurimit kanë mundësinë edhe të plotësimit te ofertës dhe të skenimit në (pdf) të cilën shumica e OE edhe e bëjnë.*

Për me tepër OE që ofertojnë duhet ta plotësojnë edhe formularin e dorëzimit te tenderit e cila përfshin çmimin e përgjithshëm dhe lexohet gjatë hapjes.

AK-ja në paramasën e qytetit dhe të fshatrave ka përshkruar tri tabela te emërtuara si (A, B,C) te cilat janë përmbledhur ne total. Fakti se ne paramasë kanë qasje të gjithë OE-të njëjtë e vërteton se nuk ka të bëjë me diskriminim.

Andaj lidhur me këtë pretendim PSH konstaton se AK-ja në mënyrë që ta lehtësojë ofertimin për OE të interesuar të marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit duhet ta vendosin edhe një faqe (Excel sheet) si rikapitullim të dy cmimoreve (qytetit dhe fshatrave), që nënkupton çmimin e përgjithshëm të ofertës poashtu duke u bazuar në faktin se çmimi i përgjithshëm vendoset në formularin e dorëzimit të tenderit.

Përfundim

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues detyrojnë Panelin që duhet të korrigjohet dosja e tenderit në përputhje me nenin 51 të LPP-se dhe nenin 54 të RRPP 001/2022 si dhe të zgjatet afati për ofertim sipas kërkesave të LPP-së.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - VIA EGNATIA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: